



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0453-A0001

Në çështjen juridike të:

Rr S, Podujevë - i përfaqësuar nga avokati B I Prishtinë.

Paditësi

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

E paditura/ankuesja

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2232, të datës 27 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2232, i datës 27 korrik 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 01 prill 2014, paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH FAN "Zahir Pajaziti", e adminstruar nga AKP (AL i AKP-së) PRN046-0752, të datës 19 mars 2014. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 1.496.12 euro, për periudhën dhjetor 2002 – mars 2003 janar, shkurt, mars 2004, dhjetor 2004- mars 2005,

me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB).

Paditësi pretendon se arsyetimi të cilin e ka dhënë AL-ja, për refuzim të kërkesës është i kundërligjshëm dhe i pa bazë. Paditësi rithekson se kërkesa e paraqitur për pagesë pranë AL-të AKP-së, nuk është e parashkruar, pasi që me Njoftimin e datës 24 mars 2006 për ndërprejen e marrëdhënies së punës, ishte ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit.

Ai si dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tijka dorëzuar: Librezën e punës, e mbyllur më 24 mars 2006, Njoftimin zyrtar për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Listën e konfirmuar për pagat e pa paguara, vendimin e kundërshtuar.

Më 14 qershor 2021, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura ka theksuar se AL-ja kishte kryer vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Sipas të paditurës kërkesa e paditësit është parashkruar dhe se periudha e parashkrimit nuk e lejon AL-në dhe Dhomën e Posçme të analizoj dhe të shqyrtoj themelin e çështjes, dhe për këtë propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazur dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Më 27 korrik 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-14-2232 me të cilin ishte aprovuar si pjesërisht e bazuar padia/ankesa e paditësit, ishte ndryshuar Vendimi i AL të AKP-së PRN046-0752, i datës 19 mars 2014 dhe ishte obliguar e paditura që paditësit, në emër të kompensimit për paga të pa paguara, t'ia paguaj shumën prej 1.029.35 euro, dhe në emër të interesit ligjor 10% të shumës së aprovuar, shumën prej 102.9 euro, të cilat do të paguhen në procedurën e likudimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, konform nenit 40 të Shtojës së Ligjit të AKP-së.

Në arsyetim të vendimit thuhet se me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.029.35 euro, gjykata është bazuar në listën e pagave të pa paguara për vitin 2003, 2004 dhe 2005. Për muajin mars 2003 i është njohur pagesa në shumë prej 137.39 euro, për muajin janar, shkurt, mars dhe dhjetor 2004 i është njohur shuma prej 595.49 euro ndërsa për muajt janar, shkurt dhe mars 2005 i është njohur shuma prej 296.49 euro, gjithësejt në shumë prej 1.029.35 euro. Kërkesa për pagat e pa paguara për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt, mars të vitit 2003, është refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre pagave të pa paguara Brenda tri vitesh nga momenti kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. Pra, kërkesa tjetër përtej shumës së

aprovuar, e që figuron në listë pagesën e pagave, nuk është e mbështetur me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë është refuzuar si e pa bazuar.

Shkalla e parë kishte konstatuar se pretendimi i të paditurës së kërkesa është parashkruar nuk është i saktë sepse parashkrimi ishte ndërprerë me Njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe pretendimi i të paditurës se kërkesa është parshkruar, nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Andaj, është konstatuar se paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh për pagat për periudhën e lartëcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara në shumën e aprovuar.

Më 11 gusht 2022, e paditura/ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në pajtim me nenin 9.10 të Ligjit 06/L-086, duke e refuzuar ankesën ndaj Vendimit PRN046-0752, të datës 19 mars 2014, si të pa bazuar dhe duke e vërtetuar të njëjtint. Sipas ankueses, Shkalla e parë ka ngatërruar dy çështje (afate) krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Afati i parë është ai për parashtrim të kërkesave, që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedure të likudimit. Ky afat kërkesën e parashtruesit e bënë të pranueshme. Afati i dytë ka të bëjë me meritat e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatoj në kerkesë, andaj një kreditor i NSH-së duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet. Nëse një kreditor dështon të përmbush një prej këtyre afateve, kërkesa e tillë do të refuzohet pavarisist faktit se ai e ka përmbushur afatin tjetër.

E paditura e kundërshton konstatimin e Shkallës së parë se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Sipas AKP-së, ky njoftim të cilit i referohet paarshtuesi, e informon atë se ai ka të drejtë të parashtroj kërkesën pranë AKP-së (jo që ai nuk ka më nevojë t'i mbroj të drejtat e tij me mjete të tjera ligjore të cilat janë në dispozicion) dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likudim. Në fakt, kërkesa e parshtruesit është shqyrtuar nga Autoriteti i Likudimit dhe në fund të procesit të shqyrtimit është konstatuar se ajo është e parashkruar.

Më 19 tetor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së e ka dërguar tek paditësi këtë ankesë për përgjigje. Paditësi në përgjigjen e tij të datës 03 nëntor 2023, thekson se pala e paditur nuk ka arritur që të ofrojë asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të saj, apo t'i rrëzoj argumentet ligjore të dhëna në vendimin e shkallës së parë të DHPGJSK-së, andaj ankesa duhet të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për qështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

AL i AKP-së kishte refuzuar kërkesën e paditësit për shkak se kërkesa ishte parashkruar konform nenit 608 të LPB-së.

Me aktgjykimin e ankimuar, Shkalla e parë e DHPGJSK-së e kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, e kishte ndryshuar Vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-së dhe e kishte obliguar të paditurën që paditësit, në emër të kompensimit për paga të pa paguara t'i paguajë shumën prej 1.029.35 euro, dhe në emër të interesit ligjor 10% të shumës së aprovuar në shumën prej 102.9 euro, të cilat do të paguhen në procedurën e likudimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave

E paditura nuk pajtohet me konstatimin e Shkallës së parë të DHPGJSK-së se kërkesa nuk është parashkruar. Ajo rithekson se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të LPB-së, pasi që nuk ka dëshmi që kjo kërkesë të jetë parashtruar para një gjykate apo organ tjetër kompetent brenda 3 vitesh nga momenti kur pretendohet të ketë lindur detyrimi.

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditurës, aktgjykimin e ankimuar dhe shkresat e landës ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor.

Kolegji i Apelit pajtohet me gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së parë sa i përketë aprovimit të shumës në lartësi prej 1.029.35. euro, pasi që kjo është bazuar në listën e pagave të pa paguara të lëshuar nga vetë NSH. Kolegji i Apelit pajtohe edhe me arsyetimin e dhënë për refuzimin e pjesës tjetër të kërkesës, pasi që ajo ishte parashkruar.

Kolegji i Apelit e mbështet tërësisht edhe arsyetimin e dhënë lidhur me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006, me të cilin ishte ndërprerë rrjedha e parashkrimit. Kjo tashmë është formësuar edhe me praktikën e pasur gjyqësore të Kolegjit të Apelit.

Kolegji i Apelit nuk e pranon argumentin e dhënë nga AKP lidhur me këtë njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, pasi që i njëjti i adresohet paditëses personalisht dhe

me të dëshmohet se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasojë e veprimit, gjegjësisht vendimit të Agjencisë. Me këtë njoftim gjithashtu dëshmohet se punëdhënësi e kishte pranuar borxhin dhe e kishte udhëzuar paditësin që këtë kërkesë mund ta dorëzoj në procedurë të likudimit, kur të fillojnë këto procedura.

Mëqenëse aspkete të tjera të kësaj kërkesë nuk janë kundërshtuar nga AKP, pos aspektit të paarskrimit, atëherë ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, për arsyet që u dhanë më lartë, dhe rrjedhmisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

AKP për ankesën e saj tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 07 dhjetor 2023.

Mr.Sc Sahit Sylejamni gjyqtar kryesues _____